



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

BURSA STUDIMI NË HUNGARI, VITI AKADEMIK 2026-2027

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës së Hungarisë, shpall programin e bursave shtetërore dypalëshe për shtetasit e huaj, studiues/lektorë të cilat përfshijnë kurset verore dhe qëndrimet kërkimore në fushën e kërkimit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë ose të Kërkimit të Hungarisë, për vitin akademik 2026- 2027, sipas kategorive të ndara si më poshtë:

- për vizita studimore afatshkurtra (3-29 ditë)
- për vizita studimore afatgjata (1-6 muaj, me mundësi vazhdimi për 10 muaj vetëm rastet e justifikuara).

Për këto studime mund të aplikojnë kandidatët të cilët kanë të paktën një diplomë të nivelit Master.

Afati i fundit për aplikim është data 19 Shkurt 2026.

Aplikimet mund të dorëzohen vetëm nëpërmjet: <https://scholarship.hu>

Thirrjet për këto bursa studimi në Hungari, duke përfshirë kushtet e aplikimit dhe listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim mund të gjenden në faqet e internetit:

<http://tka.hu/international-programmes/4133/information-for-applicants>

https://tka.hu/docs/palyazatok/call_incoming_study_visits_2026_27.pdf

DREJTORIA E INTEGRIMIT, MARRËVESHJEVE DHE PROJEKTEVE